



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

Nr. 19/25 Prot.

Dt. 22.10.2012

Nr. ... Prot.

5726/  
19

Tiranë, më 18.10.2012

**URDHËR**

Nr. 500, datë 18.10.2012

**PËR**

**AKREDITIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË PËRFUNDOJNË ME BACHELOR NË “DREJTËSI”; “EKONOMI”; PROGRAMEVE TË STUDIMIT QË PËRFUNDOJNË ME “MASTER PROFESIONAL” NË “KONTABILITET FINANCË” DHE “MENAXHIM BIZNESI” NË “AKADEMIA PROFESIONALE E BIZNESIT”**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 14.09.2011 “Për licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit”:

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 364, datë 17.09.2012 të Këshillit të Akreditimit, e programeve të studimit “Bachelor” në:
  - a. “Drejtësi”
  - b. “Ekonomi” me profile:
    - i. Banka dhe institucione financiare;
    - ii. Administrim Biznesi;
    - iii. Financë Kontabilitet,
  
2. Akreditimin në përputhje me vendimin nr. 364 datë 17.09.2012 të Këshillit të Akreditimit, e programit të studimit “Master Profesional” në:

- a. "Kontabilitet Financë"
  - b. "Menaxhim Biznesi"
3. Akademia Profesionale e Biznesit, bazuar në Vendimin nr. 364 datë 17.09.2012 të Këshillit të Akreditimit, brenda 6 muajve nga dalja e këtij urdhri, të plotësojë rekomandimet e paraqitura në vendimin e Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri.
  4. Akademia Profesionale e Biznesit do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
  5. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
  6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe Akademia Profesionale e Biznesit .

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAFAJ  
  
MINISTËR

